



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2018:052317

Datë: 18.02.2021

Numri i dokumentit: 01653482

**P.nr.1000/17**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjykuese Fitore Daci si dhe me bashkëpunëtoren profesionale Albina Varoshi-Haxhimusa, në çështjen penale kundër të pandehurit H.R., nga fshati ....., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.555-3/2017, të datës 18.04. 2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e përfaqësuesit të akuzës, Prokurores së shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, të dëmtuarit R.E.si dhe të pandehurit H.R., me datë 18.02.2021, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Kundër të pandehurit:**

H.R., i lindur me datë ....., me vendbanim në fshatin ....., Ferizaj, nga i ati F., e ëma Q., e gjinisë N., ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, i punësuar në biznesin familjar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Me datë 16 mars 2017, rreth orës 16:00 në rrugën “...” në Ferizaj për shkak të një mosmarrëveshje rreth objektit banesor “BP+7” në të cilin i pandehuri është angazhuar si mbikëqyrës, i mllfosur për shkak se i dëmtuari ka shkuar tek objekti në të cilin është bashkëinvestitor me H.A., i pandehuri fillimisht ofendon, pastaj me dashje përdorë forcë ndaj tijëj, në atë mënyrë që e kap për fyti dhe duke e tërhequr zvarrë tenton ta fut brenda në lokal, mirepo i dëmtuari arrin të largohet,

**me të cilën veprim ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.**

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 453,463, të KPPRK-së, të pandehurin e:

**G J Y K O N**

**Me dënim me gjobë në shumën prej 300€ (treqind euro), të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar të e paguaj në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të e merr formën e prerë.**

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në asnjërën prej formave të parapara me nenin 43 të KPRK-së, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim duke iu llogaritur nga 20 euro për çdo ditë burgimi.

I dëmtuari R.E., me vendbanim në Ferizaj, rruga ‘.....’, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € (njëzetë euro), si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

## **A r s y e t i m i**

### **Histroiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën e saj PP.II.Nr.555-3/17 të datës 18.04. 2017, ka ngarkuar të pandehurin H.R. për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së. Gjykata në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 18.02.2021 në të cilën seancë përfaqësuesja e akuzës-prokurorja e shtetit lexoi aktakuzën me numër PP.II.nr.555-3/17 të datës 18.04. 2017 dhe konform nenit 3 të KPRK-së, bëri rikualifikimin juridik të veprës penale dhe atë nga vepra penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, në veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, pasi që ky rikualifikim është më i favorshëm për të pandehurin.

Gjyqtarja pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 dhe përkundër paralajmërimit për nenet 325 dhe 323 të KPPK-së, të njëjtit i ofroi mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohet i pa pafajshëm.

### **Pranimi i fajësisë nga i pandehuri**

I pandehuri H.R. në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se pranoj fajësinë për veprën penale Kanosja nga neni 181 par.1 lidhur të KPRK-se, e cila i vihet në barrë me aktakuzën e prokurorit te shtetit.

Ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe i vjen keq që e ka kryer këtë veprë penale sepse me të dëmtuarin kemi pasur raporte shumë të mira shoqërore, jam i penduar thellë, kjo është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, lus gjykatën që të më shqiptojë një dënim sa më të butë dhe se i premtom gjykatës se më nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale.

### **Deklarimi i të dëmtuarit**

I dëmtuari R.E.me vendbanim në Ferizaj, rruga ‘.....’, ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe paraqet kërkesë pasurore-juridike.

### **Vlerësimi i pranimit të fajësisë**

Gjyqtarja në shqyrtimin fillestar konstatoi se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pasi që kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimin e fajit e ka bërë në mënyrë vullnetare si dhe pranimi i fajit është mbështetur në të gjitha faktet dhe provat e paraqitura nga prokurori në aktakuzë dhe me këtë janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 248 të KPPK-së, dhe në këtë mënyrë shqyrtimin fillestar e ka përfunduar pa administruar provat e tjera dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 248 të KPPK-së.

### **Vlerësimi ligjor i veprimeve të të pandehurit**

Gjyqtarja po ashtu konstatoi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-se, për të cilën veprë i pandehuri është penalisht përgjegjës dhe është gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **Vlerësimi i dënimit për të pandehurin**

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat nga neni 70 dhe 71 të KPRK-se, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të pandehurin gjykata mori për bazë pranimin e fajësisë nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestarë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, përpos që pati parasysh peshën e veprës penale dhe mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe vendosi me bindjen se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, duke i shërbyer preventivës speciale-që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepër penale dhe duke ndikuar te personat e tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale-preventiva gjenerale.

I dëmtuari R.E.me vendbanim në Ferizaj, rruga ‘...’, për të realizuar kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 453 par.1 të KPPK-se.

Obligohet i pandehuri që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

### **DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**

**P.Nr. 1000/17, datë 18.02.2021**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

**Albina Varoshi-Haxhimusa**

**Gjyqtarja**

**Fitore Daci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në drejtim të sanksionit penal.